

LIGJ
Nr. 129/2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10242, DATË 25.2.2010,
“PËR INSTITUTIN E STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT
NË SHQIPËRI”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10242, datë 25.2.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3, shkronja “a” riformulohet si më poshtë:

“a) “Periudha e komunizmit” është periudha e historisë së Shqipërisë nga 29 nëntori 1944 deri më 8 dhjetor 1990.”.

Neni 2

Në nenin 11, pika 1, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Shkronja “ç” riformulohet si më poshtë:

“ç) propozon në Kuvendin e Shqipërisë strukturën dhe organikën e institucionit;”.

2. Pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “ç/1” me këtë përmbajtje:

“ç/1) propozon në Këshillin e Ministrave buxhetin vjetor të institucionit;”.

Neni 3

Në nenin 19, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Struktura dhe organika e punonjësve të Institutit miratohen me vendim të Kuvendit të Shqipërisë.”.

Neni 4

Dispozitë kalimtare

Ngarkohet Kuvendi i Shqipërisë të miratojë strukturën dhe organikën e Institutit, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 3 të këtij ligji, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 22.10.2020.